



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:102326

Datë: 21.02.2023

Numri i dokumentit: 03996843

PPP.nr.43/2022

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, si përmbartimor, gjyqtari Avdulla Mecinaj me bashkëpunëtorin profesional Agron Geci, në çështjen juridike përmbartimor të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.a., Rr.“Vëllezërit Dragaj” pn. me seli në Mitrovicë, kundër debitorit Xh.Z., me vendbanim në Skenderaj, duke vendosur sipas propësimit të ushtruar nga debitori kundër urdhrit përmbartimor P.nr.174/22 të dt.15.03.2022, jashtë seancës gjyqësore, me dt.21.02.2023, jep këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht propësimi i debitorit Xh.Z., me vendbanim në Skenderaj.

II. SHFUQIZOHET pjesërisht Urdhëri për Lejimin e Përmbartimit P.nr.174/22 i dt.15.03.2022 për periudhën kohore nga dt.01.01.2013 deri me dt.31.12.2020 ne shumë prej 714.43 euro si borxh i parashkruar dhe **OBLIGOHET** debitori Xh.Z., që kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.a. me seli në Mitrovicë, në emër të borxhit për kryerjen e shërbimeve të bartjes së mbeturinave për periudhën kohore nga dt.01.01.2021 deri me dt.01.03.2022 t’i paguaj shumën prej 67.50 euro (gjashtëdhjetë e shtatë euro e pesëdhjetë cent), me kamat ligjore ne lartësi prej 8%, të gjitha këto në afat prej 7 dite duke filluar nga pranimi i këtij aktvendimi e gjeri në pagesën definitive të detyrimit.

A r s y e t i m

Kreditori Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.a. Rr.“Vëllezërit Dragaj” pn, në Mitrovicë, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit B.Z., me vendbanim në Skenderaj, për pagesën e borxhit për bartjen e mbeturinave për periudhën kohore nga dt.01.01.2013 deri me dt.01.03.2022 në shumë prej 781.93 euro, me kamat ligjore prej 8% dhe shpenzimet e procedurës te gjitha këto ne afat 7 ditor nga pranimi i urdhrit, ne të kundërtën

të bëhet bllokimi i llogarive bankare e nëse nuk ka mjete në llogari bankare përmbartimi të vazhdoj duke bërë regjistrimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme deri në vlerën e borxhit dhe mjetet të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuara në propozimin për përmbartim të dt.09.03.2022.

Përmbartuesi privat A.M. nga Vushtrria, me urdhrin përmbartimor P.nr.174/22 i dt.15.03.2022 e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori Xh.Z. (djali i të ndjerit B.Z.), brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, duke e kundërshtuar urdhërin për përmbartim me arsyetimin se, debitori nuk ka lidhur asnjëherë kontratë me kreditorin për bartjen e mbeturinave dhe se nuk ka pranuar asnjëherë fatura dhe as paralajmërim nga ana e kreditorit për borxhin e krijuar, më tej theksoj se borxhi i kërkuar nga kreditori është i parashkruar në bazë të dispozitave të nenit 360 të LMD-së pasi që afati i parashkrimit për fatura e lëshuara nga kreditori është një (1) vit, andaj i propozoj gjykatës që të aprovohet në tersi prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbartimit.

Kreditori në afatin e parashikuar ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar, me arsyetimin se kreditori procedurën përmbartimore e ka iniciuar në bazë të dokumentit përmbartues mbështetur në nenin 21 të LPP-së, ku relevante në këtë rast përmbartimor është të theksohet fakti crucial dhe i rëndësishëm se procedura përmbartimore ka filluar dhe është bazuar në faturat apo ekstraktet e kreditorit, të cilat përmbajnë të gjitha të dhënat e sakta lidhur me debitorin, faturat dhe ekstraktet si dokumente të besueshme duke u bazuar dhe mbështetur në nenin 40 të LPP-së, andaj i propozoj gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit në tërësi si të pabazuar dhe urdhëri i përmbartuesit privat të mbetet në fuqi duke e aprovuar.

Gjykata nga shkresat në lëndë, respektivisht deklaramentit të Xh.Z. (djali i të ndjerit B.Z.), i cili në prapësim ka theksua se debitori B.Z. ka vdek, për çka gjykata duke marr parasysh parimin e ekonomizimit të procedurës, si dhe duke marr parasysh faktin se djali i tani të ndjerit disponon me pasurin e të njëjtit, gjykata nuk veprojnë konform nenit 35 par.4 të LPP-së në atë mënyrë që ta ndërpres procedurën deri sa të caktohen trashëgimtarët të cilët disponojnë me pasurin e debitorit, andaj Xh.Z. (djali i të ndjerit B.Z.) si parashtrues i prapësimit e ka marr përsipër procedurën përmbartimore konform nenit 35 par. 6, i cili nen parashihet se “Pas mbarimit të bashkësisë trashëgimore, secili nga trashëgimtarët mund ta marrë përsipër procedurën përmbartimore duke iu paraqitur organit përmbartues”.

Gjykata në kuptim të neneve 69 e 71 të LPP, vlerësoj prapësimin e debitorit dhe gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar me arsyetimin se, arsyet e cekura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe si në nenet 69 e 71 të LPP, sipas të cilave do të pengohet përmbartimi i lejuar nga përmbartuesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit në prapësimin e parashtruar se kreditori dhe debitori asnjëherë nuk kanë lidhur kontratë për bartjen e mbeturinave dhe se nuk ka pranuar asnjëherë fatura dhe as paralajmërim nga ana e kreditorit për borxhin e krijuar, gjykata konsideron se ky pretendim nuk qëndron për faktin se në përputhje me nenin 29 par.1 pika 1.2 të LPP-së, e ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të

furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave përbëjnë dokumentet të besueshme dhe së raportet juridike në mes të kreditorit dhe debitorit në këtë rast janë të rregulluara me rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, atëherë gjykata konsideron se është përmbushur kushti për të ekzistuar raporti juridik në mes të kreditorit dhe debitorit.

Sa i përket pretendimeve të debitorit lidhur me parashkrimin gjykata të njëjtat pretendime i aprovoj pjesërisht si të bazuar duke u bazuar në nenin 360 par.1 të LMD-së, pasi që borxhi për periudhën nga data 01.01.2013 e deri me dt.31.12.2020 në shumën prej 714.43 euro është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se:“1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”.

Borxhin për periudhën kohore nga dt.01.01.2021 deri me dt.01.03.2022 në shumë prej 67.50 euro, gjykata vlerësoj se ky borxh është i bazuar dhe nuk ka parashkrim në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, kjo bazuar në nenin 360 parag.2 të LMD-së që përcaktohet se afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura, afati i parashkrimit ka filluar të rrjedhë nga dt.31.12.2021 për faktin se kreditori propozimin për përmbarim e ka parashtruar me dt.09.03.2022 me çka është ndërprerë rrjedha e afatit të parashkrimit bazuar në nenin 369 të LMD-së.

Për kamatën gjykata vendosi në bazë të nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata duke u bazuar në nenin 3, 17, 29 para 1.2 dhe parag.3, 69, 71, 73 parag.3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore e lidhur me nenin 360 par. 1 dhe 2, neni 369 të LMD, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ

**Departamenti i Përgjithshëm
PPP.nr.43/2022 me dt.21.02.2023**

**Gjyqtari,
Avdulla Mecinaj**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.